

KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot më datë 29/03/2024, palët e mëposhtme;

SHITËSI: Z. Gazmendi Aliaj, shtetas shqiptar, i biri i Pajtimit, lindur me datë 16.02.1976 ne Delvine, banues në Tirane, identifikuar me ID me numur H60216046O, madhor, me zotësi të plotë e për të vepruar (në cilësinë e Shitësit)

dhe

BLERËSI: Znj. Audrey Kola, e bija e Albertit, lindur me datë 10.03.2000 ne Canada, banues ne Tirane, identifikuar me ID , numur K05310047C , madhore, me zotësi të plotë e për të vepruar (në cilësinë e Blerësit)

vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të **100% (njqind përqind)** të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, që Shitësi zotëron në shoqërinë **"AMEO" sh.p.k. me NUIS M41414036I**.

Neni 2

Përmbajtja e kontratës

Shoqëria AMEO " sh.p.k., është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar më 07.02.2024 e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare dhe e regjistruar në Organet Tatimore me NUIS M41414036I

- (A) Shitësi, Z. Gazmendi Aliaj është ortaku i vetëm i shoqërisë **"AMEO" sh.p.k.** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas legjislacionit Shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS; M41414036I, me seli në adresën Njesia Bashkiake nr.2, rruga Vllazen Huta, Pallati Nr.6, me kapital themeltar të nënshkruar prej 100 000 Lekë, (njëqind mijë Lekë) me poshte quajtur Shitesi.
- (B) Shitesi eshte pronar dhe mbajtes i një kuote, me kapital të nënshkruar 100 000 Lekë, (njëqind mijë Lekë), që përfaqësojnë në total 100% të pjesëmarrjes së tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë).
- (C) Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi, përkatësisht kuoten, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- (D) Blerësi, Audrey Kola është e interesuar që të blejë kuotën, që përfaqëson në total 100%

në kapitalin themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 3 Çmimi i shitjes

Pala Blerëse, i paguan Palës Shitëse çmimin e shitjes 100 000 (njqind mijë) Lekë për kuotën me vlerë nominale 100 000 (njqind mijë) Lekë që përfaqëson 1 (nje) kuotë dhe 100% (njqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 4 Detyrimet e Palëve

- (A) Kuota e Shitur nga Palët Shitëse të Shoqërisë “*AMEO*” sh.p.k. dhe cdo e drejtë dhe detyrimi i cili buron prej kuotës, i kalojnë/transferohen në pronësi Palës Blerëse Znj. Audrey Kola menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, ortaku i vetëm i Shoqërisë “*AMEO*” sh.p.k., përkatësisht shitësi, humbet pronësinë dhe nuk do të jetë më zotërues/pronar i kuotës të shitur tek pala Blerëse – **Audrey Kola** dhe nuk ka dhe s’do të kenë asnjë pretendim lidhur me këtë.
- (B) Zbatimi dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk përbën shkelje të ndonjë norme, vendimi, urdhëri, vendimi gjyqësor, dekreti që i drejtohet Shitësit, apo që Shitësi është palë, apo që ka efekt mbi asetet e tij, pjesërisht apo tërësisht, apo që rezulton të krijojë ndonjë peng apo barrë mbi keto asete, përveç sa është parashikuar në këtë Marrëveshje.
- (C) Pala Blerëse fiton pronësinë e kuotës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes të këtyre kuotave dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të kuotës, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (*tatim mbi vlerën e shtuar, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifatat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat, faturime nga OSHEE-ja dhe UKT-ja etj.*); ndaj të tretëve, shoqërive tregtare dhe personave fizik (*çdo e drejtë/detyrim i cili rrjedh nga kontratë qiraje, shërbimi, enfiteoze, leasing, kredi, huaje etj*) apo cdo e drejtë/detyrim ndaj shoqërive tregtare dhe/ose organizate jo-qeveritare që ka shoqëria “*AMEO*” sh.p.k., si dhe përfshirë çdo të drejtë/detyrim i/e cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose/dhe kontraktuale i takon palës Blerëse.
- (D) Blerësi do të paguajë Çmimin e plotë të Blerjes në përputhje me këtë Kontratë. Blerësi deklaron dhe garanton se me nënshkrimin e kësaj kontrate njeh dhe pranon se është pajisur nga Shitësi me të gjithë dokumentacion e regjistrimit të Shoqërisë si dhe të aktivitetit të saj gjatë këtyre muajve.

Neni 5
Detyrimet e Palëve

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” mbi shitjen dhe Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".


Neni 6
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës, si dhe një kopje do të depozitohen në QKB.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Gazmendi Aliaj



BLERËSI

Audrey Kola



Nënshkruar në Tiranë, më datë 29/03/2024